

SHTOJCA 3

Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore

Emri i kompanisë	“ÇEKU TRADE” Sh.p.k.
Lloji i veprimtarisë	Sipërmi te rërës dhe zhavorrit
Vendi/lokacioni ku zhvillon veprimtarinë	Fshati Gorazhdevc, zona kadastrale .Gorazhdevc Peje
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës si dhe vula e kompanisë	Fatmir Çeku
Adresa	Gorazhdevc, zk.Gorazhdevc
Telefoni , fax, e-mail	+383 44355757 fatmiceku1@outlook.com
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Fatmir Çeku
Adresa	Gorazhdevc, zk.Gorazhdevc
Numri i vendimit të lejes mjedisore paraprake	17/6551/819/DMMU
Përshkrimi i dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës përfshirë numri e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	<ol style="list-style-type: none">1. Certifikatë biznesi NUI 810748692, Datë 24/06/2015.2. Vendim i Pëlqimit Mjedisor, Nr.: 16/2042/1-301/DMM. Date: 16.10.20163. Vendim i Lejes Mjedisor, Nr.: 17/6551/819/DMMU Date: 18.01.2019 Data e skadimit: 18.01.2024.4. Pëlqim komunal Nr.: IX-320-53626 Date:28.04.2016.5. Leje ujore shfrytëzim Nr; 1522/21 -ZSP- 2021 Data e lëshimit; 30.11.2021.6. Leje ujore shkarkim Nr; 1523/21 -ZSP- 2021 Data e lëshimit; 30.11.2021.7. Licencë Sortusit; 940/KPMM/2025
Fatura e pagesës se tarifës për vazhdimin e lejes mjedisore	Po
Pesë (5) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD).	Po

SHTOJCA 2

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	“ÇEKU TRADE” Sh.p.k.
	Vendi	Fshati Gorazhdevc, zona kadastrale .Gorazhdevc Peje
	Adresa	Fshati Gorazhdevc, zona kadastrale .Gorazhdevc Peje
	Nr. i tel./fax	+383 44355757
	E-mail	fatmiceku1@outlook.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	Certifikatë biznesi NUI 810748692, Datë 24/06/2015.
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Fatmir Çeku
	Nr. i tel./fax	+383 44355757
	E-mail	fatmiceku1@outlook.com
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Fatmir Çeku
	Nr. i tel./fax	+383 44355757
	E-mail	fatmiceku1@outlook.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	SIPËRMI TE RËRËS DHE ZHAVORRIT “ÇEKU TRADE” SH.P.K.
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	“ÇEKU TRADE” PEJE Sh.p.k. gjendet me lokacion ne fshatin Gorazhdevc, te komunës se Pejës.

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1.

Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur

Lokacioni ku bëhet seperimi i rërës dhe zhavorrit ndodhet në lokalitetin e fshatit Kastrat (Gorazhdec), komuna e Pejës. Komuna e Pejës shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës. Kufizohet me komunat Deçanit dhe Gjakovën në jug Istogut dhe Klinën në lindje ndërsa në veri dhe veriperëndim kufizohet me Malin e Zi.




Figure 1. Lokacioni impiantit ne hartën topografike.

Ngastrat për seperimin e rërës dhe zhavorrit ndodhet në lokalitetin e fshatit Kastrat (Gorazhdec),1700m

në përfundim nga rruga magjistrale Prishtinë- Pejë, dhe mbi 500m nga rruga e asfaltuar në drejtim të fshatit Gorazhdec. Në këtë lokacion gjenden rezerva të mëdha të rërës dhe zhavorrit prandaj edhe për arsye të kërkesave të mëdha për fraksionet e zhavorreve si në ndërtimtarin e ultë ashtu edhe atë të lart , duke pasur parasysh edhe distancën e lokacionit nga objektet banuese, në këtë lokacion kanë filluar të veprojnë edhe gurëthyes të tjerë. Në vijim po e paraqesim pjesën e hartës dhe pamjen nga sateliti ku shihet lokacioni ku është i vendosur gurëthyesi me seperacion për thërrmimin dhe seperimin.






Figure 2. Lokacioni impiantit

2.2.	Numri kadastral i parcelës	Ngastra nr. P-71611020-00049-1zona kadastrave Gorazhdec Pejë.
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	<p>Ne këtë lokacion ne afërsi të drejt për drejt nuk ekzistojnë objekte të banimit, objektet e banimit më të afërta gjenden ne anën e kundërt te rrugës se pa kategorizuar qe është ne anën veri-lindore te zonës se shfrytëzimit objektet janë te pabanuara.</p> <p>Këto objekte ndodhen në distancë mbi 250m prej seperimit te rërës dhe zhavorrit. Objekte te tjera ndodhen ne distancë 300m. Pra objektet përreth te impiantit kane karakter te ndjetë te veprimtarisë.</p>  <p>Figure 2. Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë.</p>



2.4.	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	<p>Ne lokacionin ku jemi ne dhe kemi impianti nuk ka ndonjë bimësi apo gjallës te natyrës se veçante dhe duke u bazuar në të dhënat ekzistuese nga raportet komunale, në afërsi të impiantit mund të gjendet vegetacioni i vrazhdë. Biotopet natyrore gjenden dhe përfshijnë arar, komunitetin e llojeve të bimëve barishtore, shkurret etj. Impianti nuk pritet të ketë efekte ne flore dhe faune, pasi qe ne këtë lokacion është i mbushur me një mori objekte industriale, kjo nënkupton qe tashme është atakuar flora dhe fauna nga te gjitha këto objekte.</p>
------	---	---


2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Duke u bazuar ne të dhënat e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, komunës së Pejës dhe referuar te dhënave në Gjeoportalin shtetëror te Kosovës (http://geoportal.rks-gov.net/search), në afërsi të impiantit, nuk ka zona të veçanta të mbrojtura.
------	--	--

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË


3.1.Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore

3.1.1	Skema e procesit teknologjik	Skemat e proceseve teknologjike
-------	------------------------------	--

Procesi teknologjik në impiant.



Sektori i thërmimit.



3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	<p style="text-align: center;">PËRSHKRIM I PAJISJEVE</p> <ul style="list-style-type: none"> • Transportimi i inerteve aluviale behet me kamionë,investitori ka dy kamiona. • Mercedes10m³ • Volvo. . 10m³ • Ngarkuesi 55l Liberth. 2.5m³ • Një eskavator për pune ne minier, me vëllim te ndryshëm te lugës. <p style="text-align: center;">PËRSHKRIMI I PROCESIT PËR THËRRMIMIN DHE SEPERIMIN E RËRAVE DHE ZHAVORREVE</p> <p>Pronari i kompanisë „Çeku Trade” për realizimin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e inerteve , reres dhe zhavorit posedon këto pajime të cilat i ka të vendosura ne pjesën e ngastrës të lartshënuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bunker për furnizim të seperacionit. V=7m³1a. • Dozatorë i shiritit transportues poiz. nr.2.2. • Shirit i transportit për në siten vibruese.3. • Sit vibruese (klasifikator) për ndarjen efraksioneve.4 • Impiant për pastrimin e rëres me ujë.5. • Shirit i transportit, fr. 0-4mm6. • Shirit i transportit, fr. 8-16mm7. • Shirit i transportit, fr. 4-8mm8. • Shirit i transportit, fr. 16-120mm9. • Forëtin (bunker) i thërmojsës sekondare.V=5m³10. • Shirit i transportit, për në thërmojsësekondare.11.
--------	--	--

		<p>Shirit i transportit të fr. 0-62mm nga thërmimisekonëdar në deponi.1aABBFr.0-62mm</p> <p>Inertet aluviale , zbarkohen me auto kamion vetëshkarkues në fortin nr.1 me vëllim $V=7m^3$ megranulime maksimale 120mm.</p> <p>Inertet aluviale, nga fortina lëvizin me anën e dozatorit shiritor po.1a dhe zbresin në shiritin transportues nr.2, me këto karakteristika: $L=15m$, $b=85cm$, me ngritje $\alpha=18^0$</p> <p>Shiriti transportues Nr.2 e bën transportin e inerteve aluviale ne sit vibruese nr.3.</p> <p>Sita vibruese është e pajisur me dy gypa anësor, mbisit te cilët e hudhin ujin me presion mbi sit, dube i perfshir inertet aluviale ne larjen e tyre na llojet e argjilave.</p> <p>Inertet aluviale, fr. 0-4mm kalojnë me ujë kah pjerrtësia, neper sita vibruese ne impiantin (ne form kermili) për larjen me ujë të rërës fr.0-4mm. Gjatë kalimit te këtij fraksioni, neper sit dhe impiant te larjes me ujë, impianti me rotacion (neper ujë) e tërhjekë rëren në lartësi me kënd: $\alpha=22^0$ $L=5.5m$ e transporton reren ne shiritin transportues nr. 5.</p> <p>Shiriti transportues nr.5 me kto karakteristika: $L=11.7m$, $b=50cm$, me dy rule, me ngritje $\alpha=22^0$ bëntransportin e fr. 0-4mm. të rërës së pastruar nga argjila në deponim, si të gatshme për treg.</p> <p>Fraksionet tjera, te pastruara nga uji, lëvizin kah pjerrtësia mbi sita, varsisht prej fraksioneve, zbresin ne shirita transportues: Fr. 4-8mm zbret në shiritin transportues nr.7 me këto karakteristika: $L=11.7m$, $b=50cm$, me dy rule, me ngritje $\alpha=18^0$</p> <p>Shiriti transportues nr.6, me këto karakteristika: $L=11.7m$, $b=50cm$, me dy rule, me ngritje $\alpha=18^0$ bën transportin e fr. 8-16mm.</p> <p>Shiriti transportues nr.8, me këto karakteristika: $L=11.7m$, $b=50cm$, me dy rule, me ngritje $\alpha=18^0$ bën transportin e fr. 16-120mm.</p> <p>Spektori i dytë, me thërmim është i pajisur me: Bunkerit po.9 i fraksioneve; fr.>120mm, me vellim: $V=5m^3$, mbushet me lug ngarkuese. Bunkerit është i ndërtuar: kah mesi e poshtë me pjerrtësi në formë hinke, ku</p>
--	--	--

granulimet zbresin në shiritin transportues nr.10 me këto karakteristika: $L=9m$ $b=55cm$ me dyrule, $\alpha=16.5^0$, Ben transportin e shkëmbinjve në thërmoj sekondare, ku e bën thërrmimin e shkëmbinjve në: fr. 0-120mm. Fraksionet e thermuera zbresin ne shiritin transportues po.11 me kto karakteristika: $L=11.7m$, $b=50cm$, me dy rule. Bën transportin e fr. 0-32mm në sit klasike, ku i ndan fraksionet duke rrëshqit kah pjerrtësia në: fr.0-15mm dhe fr.16-32mm.



Foto:1 dhe 2.Pamja e seperimit “Çeku Trade”

Aktivizimi në punë: Nga pulti i komandimit, aktivizohen të gjitha funksionet një nga një, duke i lëshuar shiritat transportues të fraksioneve. Pastaj, lëshohet në veprim klasifikatori (sita) pas një kohe të mjaftueshme lëshohet shiriti transportues nr.2. pas këtij shiriti lëshohet donatori nr.1a. për furnizim te impiantit me inerte aluviale.

Ndërprerja e punës në impiant. Ndërprerja e punës nëimpiant, shkon në kaheje të kundërt, me atë të aktivizimit në punë. Së pari ndërpritet dozatori po.1a e pas një kohe te mjaftueshme (kur konstatojmë se shiriti nr.2 është duke punuar në thatë) e bëjmë ndërprerjen e punës. Pas këtij shiriti, e ndërpresim klasifikatorin, dhe në fund i ndërpresim shiritat e fraksioneve.

3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	8 ore x 6 dit 48 ore ne javë orari punes prej ores 8 deri 16.
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	❖ Kapaciteti i seperacionit të rëres dhe zhavorit është 7m3/ore
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse, energjisë, uji, etj.	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Uji ❖ Energjia elektrike sigurohet nga furnizuesi i jashtëm- KEDS. ❖ Rërës dhe zhavorrit Agregati fraksionet +0-4mm +4-8mm +8-16mm
3.1.6.	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	Kompania „Çeku Trade ” Sh.p.k. Peje, sipërmi i rërës dhe zhavorrit nuk posedon rezervuar për deponimin e naftës.
3.1.7.	Lista e legjislacionit ne fuqi	<p style="text-align: center;">Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për kompletimin e kërkesës për lëshimin e Lejes Mjedisore</p> <p style="text-align: center;">LIGJET</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT ➤ LIGJI I PLANIFIKIMIT NR. 04 / L-174 ➤ LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NR. 03/L-025 ➤ LIGJI NR. 03/L-230 PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VSNM) ➤ LIGJI NR. 08/L-025 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA ➤ LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS NR. 04/L-147 ➤ LIGJI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NR. 04/L-174

- | | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none">➤ LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA➤ LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)➤ LIGJI NR. 08/L-116 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-197 PËR KIMIKATE➤ LIGJI NR. 03/L-233 PËR MBROJTJEN E NATYRES➤ LIGJI NR. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA➤ LIGJI NR. 04/L – 110 PËR NDËRTIM➤ LIGJI NR. 04/L-175 PËR INSPEKTORATIN E MJEDISIT, UJËRAVE, NATYRËS, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE NDËRTIMIT➤ LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË➤ LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA➤ LIGJI NR. 04/L-012 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI➤ LIGJI NR. 08/L-112 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-26 PËR TOKËN BUJQËSORE➤ LIGJI NR. 2003/3 PËR PYJET E KOSOVËS, NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 03/L-153➤ LIGJI NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE➤ LIGJI NR.05/L-081 PËR ENERJINË➤ LIGJI NR.05/L-085 PËR ENERJINË ELEKTRIKE➤ LIGJI NR.05/L-084 PËR RREGULLATORIN E ENERJISË |
|--|--|

➤ **LIGJI NR. 08/L-214 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L-163 PËR MINIERAT DHE MINERALET I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-158**

Udhëzimit Administrative

- *Udhëzimi administrativ Nr.04/2022 për Leje Mjedisore*
- *Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për metodologjinë e zvogëlimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat për eliminimin e pasojave*
- *Udhëzimi administrative Nr.07/2014 kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave*
- *Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme*
- *Udhëzim administrativ (mzhe) nr. 03/2017 mbi rregullat për zonat e sigurisë*
- *udhëzim administrativ (mmphi) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor*
- *udhëzim administrativ (qrk) nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes*
- *Udhëzim administrativ (mmph) nr.16/2015 për informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis*
- *Udhëzimi administrativ (QRK)-Nr.03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme*
- *Udhëzimi administrative Nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor*

		<ul style="list-style-type: none"> ➤ Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.07/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes ➤ Udhëzimi administrativ Nr. 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës ➤ Udhëzimi Administrativ për vlerat kufizuese te efluentit që shkarkohet në trup uJOR dhe në rrjetin e kanalizimit publik. ✓ UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 01/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 04/2022 PËR LEJE MJEDISORE
--	--	---

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit		
3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	<p>Çeku Trade Sh.p.k. Peje, seperimi rërës dhe zhavorrit është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm.</p> <p>Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Përmirësimin e vazhdueshëm i Mjedisit; ❖ Përmirësimin e komunikimit me autoritetet; ❖ Respektimin e legjislacionit vendor; ❖ Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit;
3.2.2.	Raportimi	Gjate kësaj periudhe sa kemi pasur leje mjedisore kemi raportuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse	<p>Gjatë funksionimit kontinuel të kompanisë Çeku Trade Sh.p.k. Peje, për seperimi i rërës dhe zhavorrit ndotja e ajrit vjen nga qarkullimet e automjeteve transportuese te rërës dhe zhavorrit. Gazrat nga djegëjet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO2 dhe pluhuri. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike –meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin e kompleksit për.Pluhurat të cilat lirohen nga deponitë të cilat nevojiten për deponimin e masës se minuar. Pluhurat të cilat lirohen gjate ngarkimit dhe transportimit të masës se minuar. Gjatë realizimit të procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit, ndikime negative në ajër ndodhin edhe nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Pluhuri i cili lirohet çdo herë në momentin ethyerjes së zhavorreve, do të thotë te thërrmuesja. •Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit tëfraksioneve ne të gjithë shiritat transportues. •Pluhurat të cilët lirohen gjatë seperimit të fraksioneve ne sitat vibruese. •Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të materialit të thërrmuar. •Pluhurat të cilët lirohen nga mekanizmi ngarkues ifraksioneve në automjetet transportuese. •Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale që ndodhën në afërsi të gurëthyesit me seperacion. •Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e ngarkimi dhe transportit.
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajërti	<p>Ndikimi i emisionit të materieve ndotëse në kualitetin e ajrit varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe numri i automjetet transportuese që transportojnë fraksioneve të materialit. Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë funksionimit te kompleksit te seperimit rërës dhe zhavorrit duhet marren këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Transporti i masës se rërës dhe zhavorrit duhet te mbulohet me çadër apo folie najlloni. ❖ E gjithë hapsira e kompleksit te mihjes duhet të spërkatet me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta.

		❖ Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i makinave që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzëve të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjetet brenda dhe jashtë kompleksit te te mihjes. Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të agregatit, emetimi i pluhurit nga sipërfaqet manipuluese.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Nuk kemi, pasi qe nuk ka shkarkime te gazave nga ky proces.
4.5.	Pajisjet për de - pluhurim	Nuk kemi. Vetëm e përdorim ujin si spërkatje për mos me lanë me u ngrit pluhuri ne atmosfere.
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Kompania: „Çeku Trade “ shpk, Peje për sipërmin i rërës dhe zhavorrit kemi bërë Monitorimin e emisioneve pasi qe na është kërkuar për raportim ne MMPHI.
4.7.	Monitorimi i emisioneve/cilësisë së ajrit	Kompania „Çeku Trade “ shpk,Peje për sipërmin i rërës dhe zhavorrit kemi bërë Monitorimin e emisioneve pasi qe na është kërkuar për raportim ne MMPHI.
4.8.	Raportimet	Kemi be raportime në MMPHI, duke respektuar kërkesat e autoriteteve mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Për ta parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative ne ajër te cilat i kemi cekur më lart, rrugët ku behet transportimi i masës se rërës dhe zhavorrit duhetvazhdimisht te spërkatet me ujë. Për te parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative ne ajër, gjatë procesit teknologjik te eksploatimit dhe sipërmin e rërës dhe zhavorrit përposmasave te lart cekura duhet ndërmarr edhe këto masa: Duhet te behet kontrollimi i rregullt i automjeteve te renda dhe konsumuesve tjerë me lend të lëngëta djegëse me qellim të zvogëlimit të emisioneve në ajër.
4.10	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Për ta parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative ne ndryshimet klimatike lokale, i kemi marre këto masa qe jane; rrugët ku behet transportimi i masës se rërës dhe zhavorrit mirëmbahen vazhdimisht te spërkatet me ujë, behet kontrollimi i rregullt i automjeteve te renda dhe konsumuesve tjerë me lëndë të lëngëta djegëse me qellim të zvogëlimit të emisioneve në ajër.

5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Uji përdoret për nevoja të procesit teknologjik për sipërmin e rërës dhe zhavorrit dhe larjen e stabilimenteve.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësore apo në rrjetin e kanalizimit	Ujërat shkarkohen nga procesi teknologjik dhe trajtohen për mese gropës sedimentuese ku me pas uji kthehet përsëri në procesin teknologjik pasi të kalon procesin e fundërrimit në basenet sedimentues të ujërave.
5.3.	Ndikimet në ujë	Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore është nëse vije nga të reshurat atmosferike të cilat gjatë rrjedhjes së tyre në zonat e shfrytëzimit në vendburim mund të jenë të ndikuara nga materiale të ndotura dhe të njëjta të rrisin papastërtinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Dhe në rastet kur kemi derdhje aksidentale të derivateve të makinerive që përdoren në këtë proces dhe nëse nuk trajtohen ujërat që dalin nga ky proces teknologjik.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura – treguesi i emisioneve kryesore	Në kompaninë „Çeku Trade“ shpk, Pejë për shpërndarjen e rërës dhe zhavorrit nuk gjeneron ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, pasi që ndërrimin e vajrave nuk e bënë brenda kompleksit por në autoservis andaj edhe nuk ka emisione të ujërave të ndotura. Ndërsa ujërat që përdoren për sipërmi trajtohen në gropën septike.
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Kemi ndërtuar gropën sedimentuese, të cilët mbledhin ujërat nga sipërfaqja operationale e betonuar dhe ujërat që dalin nga procesi teknologjik i prodhimit të betonit. Për ujërat fekale kemi ndërtuar gropën septike.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Kemi bërë matje dhe kontroll.
5.7.	Raportimi	Sipas udhëzimeve që janë dale nga leja për shfrytëzimin dhe shkarkimin e ujërave, raportimi bëhet tek Autoriteti Rajonal i Pëllgjeve Lumore – ARPL për shkarkimet në ujëra.
5.8.	Leje ujore për shfrytëzimin e ujit	Jemi pajisur me leje ujore për shfrytëzimin e ujërave.

5.9.	Leje ujore për shkarkimin e ujërave	Jemi pajisur me leje ujore për shkarkimin e ujërave nga ARPL.
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Ne si kompani kemi ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e ndotjes së ujërave si: ndërtimi i gropës sedimentuese për ujërat e procesit teknologjik.
6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Ne ambientet tona zhurma krijohet kryesisht nga seperacioni, automjetet të cilat qarkullojnë brenda dhe jashtë kompleksit të impiantit, si dhe nga gjeneratori, në rastet kur mungon energjia elektrike.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Kemi bere kur është kërkuar kontrollit dhe matjeve të zhurmës.
6.3.	Raportimet	Kemi bërë raportime në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	<p>Si ndikim negativ në tokë gjatë realizimit të procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e reres dhe zhavorrit mund të shkaktohen nga :</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Deponimi i fraksioneve të prodhuara nga gurthyesi dhe seperacioni dhe mbeturinat nga këto prodhime. ❖ Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmave, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. ❖ Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), ❖ Ndikimet nga ngjeshja e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese. ❖ Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	<p>Janë marre këto masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë;</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet e thërrmimit dhe seperimit. ❖ Jane merën masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.

		<ul style="list-style-type: none"> ❖ Vaji i makinave ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë dhe atë ne ofiçinën për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese. ❖ Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në lokacionin e gurëthyesit me seperacion për shkak te avarive ne makinat ngarkuese dhe transportuese, atëherë jane siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet. ❖ Si masë tjetër për mbrojtjen e tokës rekomandohet që në kohëra kur ka të reshura atmosferike të mos punohet me makina të rënda, me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës. ❖ Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohet në lokacionin e gurëthyesit me seperacion grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara. ❖ Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin regjionale. ❖ Platoja dhe sipërfaqet operationale ku bëhet mirëmbajta (servisimi) i makinave transportuese dhe pajimeve prodhuese të betonohet dhe izolohet. ❖ Platoja dhe sipërfaqet operationale ku vendoset gjeneratori të betonohet dhe izolohet. ❖ Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtjes së pajimeve të gurëthyesit me seperacion duhet të deponohen në enë të posaçme , dhe do të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura. ❖ Kamionët të cilët bëjnë transportin e rërës dhe zhavorit duhet të mbuloen me mbulesa adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes së rërës dhe zhavorit që transportohet.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	<p>Ne nuk planifikojmë te ndërpres aktivitetin ne një te ardhme te afërte, mirëpo nëse ne rast se vendos te ndërpres aktivitetin do te veprojm ne ketë mënyre ku;</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ pas përfundimit te aktivitetit, objektet ekzistuese do të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platos nga betoni do të shkatërrohen, imtësohen dhe do të dërgohen në depono të materialeve inerte. ❖ Pastaj do të bëhet zëvendësimi me një shtresë të humusit prej 0.5 m trashësi, të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj do të bëhet ngjeshja e shtresës së humusit, ashtu që do të krijohet një substrat i favorshëm për rikultivim.

		❖ Kompania do ti zbatoj te gjitha obligimet te cilat janë marruar nga KPMM ne momentin e marrjes se licencës, ku ne baze te ligjeve për miniera dhe minerale është bo edhe një garancion bankare për këtë qellim.
--	--	---

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE		
8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut shtetëror të Mbeturinave	Mbeturina komunale i deponojmë për kohësisht në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë nga kompania e licencuar, e cila i dërgon në deponinë regjionale për deponim të mbeturinave.
8.2.	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Nuk bëjmë magazinimin e përkohshëm të mbeturinave, mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosën në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, pastaj merren nga kompania e mbeturinave.
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Nuk behet trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave.
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër – kontratë me kompaninë me leje përkatëse	Nuk behet trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave.
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Plani për menaxhimin e mbeturinave behet duke bere klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave, e bëjmë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060. Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësore.

8.6.	Raportimi	Nuk bëhet raportim lidhur me menaxhimin e mbeturinave pasi që kompania mbeturinat e grumbulluara komunale i merr kompania e licencuar për menaxhim me mbeturina.
9. RREZIKU NGA AKSIDENTET		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	<p>Në Kompaninë „Çeku Trade ” Sh.p.k. Peje, Eksploatim dhe seperimi i reres dhe zhavorit nuk kemi deponim te karburanteve të lëngët nga edhe buron rrezikimi i mjedisit gjatë rasteve aksidentale. Aksidentet mund te ndodhin nga rrjedhjet e lendeve djegese dhe lubrifikuese nga automjetet transportuese nga pelcitja e gypave hidraulikë. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo fazë të proceseve teknologjike në kompleksin e vendburimit si:</p> <p>Plani i brendshëm do te përmbana:</p> <p>Objektivat e Planit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Ruajtja dhe mbrojtja e Mjedisit ❖ Parandalimi i zjarreve; ❖ Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve; ❖ Mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale; ❖ Vlerësimi i rrezikut; ❖ Qëllimi i planit: <p>Qëllimi i hartimit te këtij Plani është krijimi i prioriteteve për një koordinim sa me efikas ne mes te subjekteve te cilat janë përgjegjëse qe te veprojnë shpejtë dhe me efikasitet ne rastet e fatkeqësive - zjarreve.</p> <p>Koordinimi i veprimeve ne raste të zjarreve. Zvogëlimi te rrezikut, gatishmëria për te mare vendime të duhura he kthimin e shpejtë te shoqërisë ne jetën normale.</p> <p>Plani i jashtëm:</p> <p>Qëllimet kryesore te këtij Plani janë:</p> <p>Të tërheqë vëmendjen e përdoruesve dhe te autoriteteve përkatëse ndaj mundësisë se ndodhisë te një aksidenti dhe ndaj zbatimit te masave te nevojshme për shmangien e tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Të shmange efektet serioze (si p.sh. vdekjet nga aksidentet).

		<ul style="list-style-type: none"> ❖ Të zvogëloje rrezikun e ndodhjes se aksidenteve ose te zbusë pasojat e aksidenteve kur ato eventualisht ndodhin. ❖ Për realizimin e objektivat të mësipërme, ky plan përmban këto çështje: ❖ Trajnimi i punëtoreve; ❖ Ekipet e emergjencave dhe përgjegjësit e tyre; ❖ Kushtet e emergjencave dhe veprimet mbrojtëse.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Nuk përdoren substanca të rrezikshme kimike dhe preparate.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	<p>Ne kemi ndërmarr këto masa për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Kemi siguruar pajisje kundër zjarrit si dhe enët me rërë. ❖ Kemi bere rrethojën e gjithë hapësirës punuese.
9.3.1.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kemi hartuar raportin për gjendjen e sigurisë.
9.3.2.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Kemi hartuar planin për mbrojtjen nga zjarri gjate marrjes se lejes ndërtimore.
10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Ne kompaninë tone, tani për tani nuk ka ndërprerja momentale e punës së impiantit, mirëpo mund të ndodhë në rastet e rrjedhjeve aksidentale të derivateve dhe vajrave, nëse kemi defekte në sistemin e depluhurimit (filtrave), deri në sajimin e gjendjes dhe kthimin e tyre në funksion, si dhe në rastet aksidentale të shkaktimit të zjarrit.
10.2.	Ndërprerja e punës	Ne nuk kemi planifikuar ndërprerjen e punës, mirëpo nëse vjen deri te ndërprerja e punës, kemi bërë planin e rehabilitim dhe ri kultivimit.
11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT		

Marre ne konsiderate proceset teknologjike qe zhvillohet ne hapësirën dhe nga kompania jone qe është sipërmi i rërës dhe zhavorrit ndikimet e mundshëm e ndotjes në shëndetin e njeriut është shumë i vogël, pasi që kemi ndërmarr të gjitha masat për zvogëlimin e ndikimeve në shëndetin e njeriut dhe ka marr gjitha masat ne procesin e punës.

Personi përgjegjës për mjedis

Emri Mbiemri Fatmir Çeku

Nënshkrimi

Personi përgjegjës i kompanisë

Emri Mbiemri: Fatmir Çeku

Nënshkrimi



Figura 1. Pamje e gropës septike për trajtimin e ujerave. Date; 15.10.2025



Figura 2. Pamje e rrethojave te punishtes dha hapësirës gjelbëruese. Date; ; 15.10.2025



Figura 3. Pamje e ambientit te punës. Date; ; 15.03.2026